



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

00 Numër: 46/2023

Data: 15.09.2023



Komuna e Istog

Opština Istok

Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 19-të të rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja do të mbahet më: **25.09.2023, eHënë**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2024 - 2026,
4. Shpallja në diskutim Publik e Draft - Statutit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Istogut
5. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e pesëmbëdhjeta e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **31.08.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 13. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 14. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 15. <u>Negidet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 16. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 17. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 18. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 19. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 20. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 9. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 21. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 10. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 11. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 23. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 12. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, Nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të, monitoruesja nga DEMOS – KDI, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD^{te} e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: : "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Hap punimet për mbledhjen e tetëmbëdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të DKA-së për vitin shkollor 2022-2023;
4. Formimi i komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve nëpër shkolla K. Istog;
5. Falja e Borxhit të tatimit në pronë deri në shumën prej 100 €, sipas Ligjit Nr. 08/L-225 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-006 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme ;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi?

Florin Dreshaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, zakonisht në muajin gusht kemi pasur pushim pse tash thirret mbledhje me dy pika te rendit të ditës cili është qëllimi i kësaj mbledhje a është qëllimi veç me i marr qato mëditje apo vërtet ka pas diçka urgjente.

Kryesuesi i Kuvendit – keni të drejt ne e kemi paralajmëruar si pushim por Kuvendi është Kuvend nuk është me dy pika por i ka se paku tri. Edhe në shkresë nga Ministria na obligon me thirr mbledhjen.

Kryesuesi i Kuvendit – pyet anëtarët e Kuvendit a jeni që të miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje.

Hedh në votim rendin e ditës

Miratohet unanim rendi i ditës për këtë mbledhje.

Konstatojmë që 24 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit - në mbledhje mungojnë: tre anëtar të cilët janë lajmëruar që nuk mund të marrin pjesë në mbledhje: Njomza Demaj, Melis Smakic dhe Qerim Rexhaj, për arsye shëndetësore.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Kryesuesi i Kuvendit – pyet nëse ka edhe dikush diçka,

Pasi që nuk keni diçka,

Hedh në miratim

Miratohet unanim pa vërejtje.

Konstatohet që me 24 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 31.08.2023.

Shqyrtimi i pikës së 3.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2023.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj, përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Raportit vjetor të DKA-së për vitin shkollor 2022-2023.

Hajrush Shoshi – përshëndet të gjithë të pranishmit, për nxënës mbi 4 kilometra kemi dy relacione me nxënës të cilët duhet të planifikohen për vitin 2024 Dubov e Vogel- Banjë është mbi 4 kilometra edhe Llugat e Saradranit lagjet “ Gashi dhe Nikqi” deri të shkolla fillore në Saradran janë së paku edhe dy relacione tjera se tejkalojnë këtë largësi.

Në raport të përmirësohet jo 140 bursa por 144 bursa te jetë shifra e saktë.

Te kemi një raport me gjithëpërfshirës te përfshihet në këtë raport 2 projekte të cilat janë zhvilluar në shkollën e mesme profesionale „Mithat Frasheri” në Gjurakoc .

Agron Gashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, raporti është pak i mangët me 4 faqe raport besoj që edhe ekzekutivi ka mundur me përfshi edhe punë të mira që janë bere e që nuk i ka përfshirë hiq edhe disa punë që ka mundur me i përfshirë që janë rezultate konkrete e që nuk janë në këtë raport e qe ne na interesojnë në kuadër të ngritjes së cilësisë në arsim kryesisht në këtë raport është përmendur transporti konkurset dhe investimet kapitale, jo materja jo pjesa e ngritjes së cilësisë në arsim apo rezultatet. I kam pa disa ngecje te këtij raporti që janë përfshirë, ndarja e institucioneve edukativo-arsimore duke filluar nga parashkolloret dhe institucionet private, si po funksionojnë çka ka te meta çka ka mangësi në to pastaj rezultateve e garave komunale në çdo raport në çdo kuvend se si po ecin këto gara, pastaj rezultatet dhe të arriturat e testeve me pa se ku jemi si kemi dal si është gjendja, puna e cilësisë nuk është përmendur hiq veç pjesa e projekteve kapitale. Pastaj praktikat profesionale sa po zbatohen ato praktika profesionale sa janë të gatshme bizneset ku janë përgatitjet nga ekzekutivi apo ne me i ndihmuar . ne na intereson ku ka ec arsimi nga vitet e kaluara cilat janë sfidat e këto.

Nimon Beqiraj – përshëndet të gjithë të pranishmit, tek transporti i nxënësve në mbi 4 kilometra tani në vija të reja që do ti bëni ta kini parasysh edhe rrezikshmërinë e rrugëve dhe mungesën e trotuareve kemi fshatrat Zabllae e Drejë prindërit paguajnë transportin për shkak të arsyejeve që përmenda nuk mund ti len të shkojnë vetë.

Florin Dreshaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, ku raport për mua ka qenë torturë me e lexuar këtë katër faqe dhe me mëndu që është raport me shumë i ka përngjaj një hartimi të shkollës fillore se sa një raport ka pasur dobësi edhe në përmbajtje edhe në formë, raporti është bërë me shumë gabime sa që kanihere e kanë hup kuptimin me hi ka gramatika kryefjala është në njëjës ndërsa kallëzuesin në shumës e qesim parafjalën në vend të nyesë përpiluesi i këtij raporti nuk e di a i ka ra ka shkolla e mesme ndonjë here sepse nxënës me qenë këto është dashur me i ditë. Ceket diçka dhe nuk sqarohet se çka. Kisha dashur ta di sa nxënës përfitojnë nga transporti me mbi 4 kilometra largësi nga shkolla. Nuk e di cilat shkolla kanë marrë nxënësit uniforma sa ka qenë ky numër i uniformave dhe sa ka qenë shuma që janë shpenzuar për to.

Naim Behlulaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, sqaron pyetjet dhe vërejtjet e bëra.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, në KPF e kemi realizuar shumicën e këtyre që kanë qenë në vitin e kaluar mësimor 2022-2023 e shumica e kolegëve i bënë pyetjet që unë i kam paralajmëruar edhe meqenëse e mora fjalën së fundmi pata dilemë pajisjen e uniformave të nxënësve ne për shkollën fillore megjithëse drejtori veç e dha përgjigjen faleminderit nga ata.

A e din natyrën e trajnimeve që sivjet kanë me u organizuar?

A janë përfunduar të gjitha konkurset për mësimdhënës?

Sa bursa doni sivjet me i nda?

Pos lendeve djegëse drunore e tjera a përfshihen edhe lënde tjera këtu?

Pajisja e kabineteve ne si shkollë kemi bërë një krekës rreth reagjentëve në kabinetin e kimisë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Pasi që jo po kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, Formimi i komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve nëpër shkollën K. Istogut.

Naim Behlulaj- faleminderit për fjalën kryetar! Pasi që udhëzimi administrativ e parasheh që çdo vit të kemi përzgjedhjen e komisionit për vlerësimin apo përzgjedhjen e drejtorëve dhe zv. drejtorëve në institucione shkollore ne propozojmë që nga DKA pjesë e komisionit të jetë Naim Sadriu pasi që e ka përfunduar trajnimin e duhur për vlerësim dhe nga shkollat drejtoresha Mimoza Kabashi.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Hapim diskutimin, por këto janë propozime të drejtorisë. Për korrektësi më duhet ta lajmëroj që anëtari i Kuvendit z. Faruk Kabashi nuk ka të drejtë të marrë pjesë në votim për shkak të afërsisë me anëtarin e komisionit të cilën e ka bashkëshorte dhe ka dalë nga mbledhja para se të fillonte kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- E hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës, kush është që të jetë ky komision për vitin kalendarik? Kush është për?

Konstatohet që nga 22 anëtarë të Kuvendit me 16 vota për 5 kundër dhe 1 abstenim miratohet pika e rendit të ditës formimi i komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve nëpër shkolla të Komunës së Istogut.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e pestë Falja e Borxhit të tatimit në pronë deri në shumën prej 100 €, sipas Ligjit Nr. 08/L-225 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-006 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

E kemi një letër nga ministria e Ekonomisë Punës dhe Transfereve që te falja e borxhit të tatimit në pronë deri në shumën 100 euro sipas ligjit nr. 08/L-225 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-006 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme na e kanë caktuar një datë deri kur mundemi me e shqyrtuar është 15 shtatori por pasi që u thirr kjo mbledhje e kemi parë më të arsyeshme që ta fusim si diskutim apo shqyrtim në këtë mbledhje. Materiali është ky, dhe e kemi parë të arsyeshme që ta sjellim në Kuvend sepse është shumë e rëndësishme sepse e përfshinë në impakt pjesën më të gjerë të qytetarëve në komunën tonë. Fjalën e ka kryetari i komunës z. Ilir Ferati.

Kryetari i komunës- faleminderit kryesues! Përsëritet të gjithë të pranishmit! Siç e tha kryesuesi ka ardhur prej ministrisë me qëllimin që me e lehtësuar atë barrën tatimore që është ngarkuar pas rritjes së koeficientit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që janë në pronësi të qytetarëve të komunës. Pikë të cilën e kemi shqyrtuar edhe në KPF, dhe jemi dakorduar ta sjellim në Kuvend, por pa ndonjë rekomandim të veçantë në mënyrë që me pas një diskutim të përbashkët me anëtarët e Kuvendit. E që edhe me dërgimin e këtij ligji në Gjykatën kushtetuese na obligon me e prit përgjigjen e Gjykatës me e parë se a po del ligji në kundërshtim me kushtetutshmërinë e vendit apo jo. Mendoj që ka qenë një plotësim ndryshim i shpejt dhe i ngutshëm, është dashtë të bëhet në procedurë të rregullt të plotësim ndryshimeve të ligjeve që i bën Kuvendi i Republikës së Kosovës që të bëhet pjesë edhe e grupeve punuese edhe diskutimeve. Ligji i ka dy, pika parë është shuma e faljes së tatimit në pronë për

të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë 100 euro dhe e dyta mundësia me e ndryshuar normën e tatimit nga 15 deri në 10. Afati parë i këtij është deri me 15 shtator, uroj dhe shpresoj që Gjykata kushtetuese del me një vendim të paktën ose me një konfirmim të kushtetutshmërisë të Ligjit që është dërguar nga Asociacioni i komunave të Kosovës. Një buxhet siç është i komunës tonë, është jashtëzakonisht e papërballueshme me e proceduar, pse po e them këtë, sepse mua më duket me një shije të këndshme politike që kur del dhe me ballë hapur ju thua qytetarëve që ua kemi falur nga 100 euro por të idhtit e atij veprimi del kur vitin e ardhshëm nuk i kryhet një trotuar apo një rrugë, një copë ujësjellësi, janë penalitete që mundem me i vuajtur si ekzekutiv në kuptim të realizimit të obligimeve tona të cilat i kemi marrë para qytetarëve. Nuk po e zgjati më shumë fjalën ja kaloj drejtorit ta bëj një sqarim më profesional edhe të numrave të këtyre efekteve e pastaj mundemi me diskutuar.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar, fjalën e ka drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Genc Ademaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe sqaron pikën e rendit të ditës Falja e borxhit të tatimit në pronë deri në shumën 100 euro sipas Ligjit nr. 08/L-225 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-006 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Florin Dreshaj- kjo pikë e rendit të ditës për mua dhe për Lëvizjen Vetëvendosje është pak delikate sepse normal që jemi për me e falur dhe me ju ndihmuar qytetarëve por normal që nuk jemi për me e zvogëluar buxhetin e komunës. Na tregoi edhe drejtori që afër 600 mijë euro zvogëlohet buxheti i komunës por megjithatë duke besuar qeveria nuk ka me na lënë keq, d.m.th nëse kemi ndonjë ngecje dhe deri tash të gjitha projektet që i ka dërguar Istogu nuk janë refuzuar gati asnjë dhe duke llogaritur që Istogu ashtu kështu nuk po din me i planifikuar dhe po i teprojnë më shumë se 1 milionë euro, atëherë duke u bazuar në këto jemi pro kësaj falje.

Agron Gashi- faleminderit kryesues! Edhe ne e kemi lexuar dhe i kemi parë këto pjesë që janë diskutuar në komuna tjera sepse në komuna tjera ka ardhur edhe më herët, e dimë që ky ligj është në Gjykatën kushtetuese për shkak të implikimeve buxhetore. Ne e dimë që komunat financohen dhe e marrin buxhetin nga të hyrat vetanake, kështu që ne me këtë veprim mundemi me e bërë një diçka të mirë individualisht për qytetarët me ja u dhënë ka 100 euro, mirëpo në kuadër të pjesëve kolektive kemi me e bërë një dëm të madh sepse ka me i munguar infrastruktura atij qytetari. E dimë që shumë qytetarë tashmë po participojnë edhe në rrugë, tash ne po ja japim 100 euro po kemi me ja u ndal atë rrugë. Kështu që te kjo pjesë kisha thanë me e prit Gjykatën kushtetuese, ashtu siç tha drejtori, nëse duam e bëjmë edhe një seancë të jashtëzakonshme sepse ta obligon edhe ligji edhe nuk ke se çfarë bën. Por askush nuk është që mos ti

ndihmojmë qytetarëve, por kjo është e keqe më e madhe nëse qytetarëve nëse ne ua heqim buxhetin komunës ku ata jetojnë prej këtij buxheti. Faleminderit shumë!

Hajrush Shoshi- unë e dëgjova me vëmendje edhe kryetarin, drejtorin e financave edhe parafolësit e mi. Unë besoj që presioni i komunave për uljen e tatimit në pronë e ka rritur qëllimin sepse shkalla e tatimit në pronë për vitin e ardhshëm është mundësi të ulët nga 0.15 në 0.1, i bie diku 33% dhe të gjithë qytetarët e komunës së Istogut tatimin në pronë për vitin e ardhshëm do ta paguajnë diku 33% ma lirë. Për këtë vit nuk e besoj asnjë qytetarë që nuk është i interesuar që ta paguajë tatimin në pronë, përkundrazi të gjithë janë të interesuar. Prandaj nuk është e udhës që të bëjmë falje prej 100 euro sepse dëmtohet buxheti i komunës tonë. Faleminderit!

Genc Ademaj- jep sqarime shtesë te pjesa e kërkesave që ka rrjedh.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha një sqarim a po ngritet 33% a po ulet tatimi në pronë se Hajrushu tha po ulet unë mendoj se po ngritet.

Genc Ademaj- këtë do ta definojmë bashkë me juve në mbledhjen e nëntorit ku e kemi edhe obligim që çdo komunë me marrë vendim normën e tatimit në pronë. Është mundësi e uljes për vitin e ardhshëm 2024 por bashkë me juve e elaborojmë.

Kryesuesi i Kuvendit- a e dëshiron edhe dikush fjalën? Pasi që jo po e hedhim në votim, propozimin e kryetarit që ta presim vendimin e Gjykatës kushtetuese edhe opinioni ishte sa pata mundësi ta vërej prej shumicës së këshilltarëve, kështu që kush është që vendimi i Kuvendit përputhet me dërgesën e Ligjit në Gjykatën kushtetuese d.m.th ta presim një vendim pasi që ndërlihet edhe me vendimin e Kuvendit tonë. D.m.th pika shtyhet sepse afatin e kemi deri me 15 shtator dhe mundemi me e thirr një mbledhje të jashtëzakonshme.

Kryetari i komunës- nëse më lejohej, sa pashë unë përpos përfaqësuesve të lëvizjes Vetëvendosje të tjerët ishin të dakordimit që mos të bëhet. Përkundër që ne jemi të obliguar që ta presim vendimin e Gjykatës, tash a duhet të hedhet në votim a jo ligjërish nuk e di si shkon.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- faleminderit kryesues! Në qoftë se është mundësia vetëm me e shtyrë e me e prit vendimin e Gjykatës atëherë jemi edhe ne pro, por në qoftë se e kemi obligim para datës 15 shtator me e marrë një vendim nuk kemi nevojë me thirr mbledhje të jashtëzakonshme për këtë punë, mundemi me marrë edhe tani, po shihet si ka me u votuar le të votohet.

Kryesuesi i Kuvendit- shiko Florin, ne mundemi me e ndërprerë mbledhjen e me e shtyrë deri me datën 15 shtator, mundemi që vetëm këtë pikë të rendit të ditës ta shtyjme dhe vazhdojmë me debat pastaj si e kanë kërkuar datën me 15 shtator. I kemi dy mundësi.

Florin Dreshaj- unë po mendoj nëse duhet të merret një vendim para 15 shtatorit atëherë mundemi me e marrë sot e mos me pasur nevojë me thirr një mbledhje të jashtëzakonshme.

Kryetari i komunës- propozimi im ishte që vendimi mos të merret deri sa të jepet vendimi i Gjykatës kushtetuese.

Florin Dreshaj- ligjërisht a e kemi atë mundësi, nëse po normal që jemi edhe ne me e prit vendimin e Gjykatës.

Kryetari i komunës- edhe nëse Gjykata nuk merr vendim deri me 15 shtator ata kur dalin me verdikt që është e obliguar me e respektuar edhe qeveria edhe parlamenti edhe ne.

Hajrush Shoshi- unë besoj që ligji nuk na obligon neve që gjithsesi të marrim një vendim deri me 15 shtator. Diskutimet që u bënë faktikisht shumica ishin pro të prolongohet kjo punë. Nëse ekzekutivi e sheh që është interes që të bëhet ndonjë falje mundet me 14 shtator me thirr mbledhjen dhe me e bërë një falje çfarë mendon ekzekutivi, besoj që të gjithë jemi pro që tatimi në pronë të paguhet. Nuk kemi as çka të shtyjme as çka të vendosim as çka të votojmë.

Kryesuesi i Kuvendit- Hajrush duhet po ose jo. Ne duhet të marrim një vendim a duam ta shtyjme deri në vendimin e Gjykatës kushtetuese, kush është që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës deri në vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës kushtetuese?

Konstatohet që nga 23 anëtarë të Kuvendit në mënyrë unanime votohet që kjo pikë e rendit të ditës 'Falja e borxhit të tatimit në pronë deri në shumën 100 euro sipas Ligjit nr. 08/L-225 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-006 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme' të shtyhet deri në vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës kushtetuese.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e fundit Pyetje nga anëtarët e Kuvendit. A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Negjdet Ramaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, çka po ndodh me projektin e ujësjellësit mbivada banoret e asaj ane po ndihen të anashkaluar nga ju pasi qenë fushat

keni premtuar që ky problem do të zgjidhet brenda ditësh. Pyetja është se mos po pritni se edhe në zgjedhjet tjera ta kërkon votën duke premtuar ujë në mbi vaden.

Kryetari i Komunës – Negj unë jam kryetar i 52 fshatrave të komunës së Istogut dhe hallet e të gjithëve janë edhe hallet e mijë. Jemi duke bërë presion të jashtëzakonshëm të kompania që nuk ka mundur me e bërë gjatë muajve të verës për shkak të sasisë së madhe të ujit në burim, gjë që nuk ka ndodhur që disa vite.

Niman Beqiraj – kam disa pyetje dhe një sqarim në rrugën “Bardh Isufi” e kam për kërkesën me emrat e cila është dorëzuar edhe në komunë (kërkesën me emra ja dorëzon z. Hajrush Shoshi).

Ndriçimi publik i vendosur mbi murin e xhamisë në rrugën “Feriz Blakaj” e cila lidhet edhe me rr. “Muharrem Vuthaj” është një ndriçim rreth 150m aj ndriçim është i lidhur në orën e rrymës së xhamisë dhe është bërë barre e rënd për xhaminë si qëndron puna dhe a është e mundur të kalojë në pagës të komunës pasi që është ndriçim publik dhe dy rrugë po ndriçohen.

Krëkës nga punëtorët të cilët kanë punuar roje të shtëpia e kulturës në Istog, nuk kanë me kontratë dhe nuk vijon punën mirë po ata kanë vijuar punën edhe 6 muaj pas kontratës dhe thonë se për ata 6 muaj nuk janë paguar.

Komuna ti mendoj me shumë vendimet në të ardhmen të cilat i merr sigurisht ato po shkaktojnë pastaj me shumë kosto shtesë për buxhetin është rasti të rrethojat e xhamisë së re të cilat i keni larguar me bager na ka jep një sqarim drejtorit që kanë qenë pa leje e nuk kemi reaguar asnjë herë mirë po ato prap janë vendosur në vendin e njëjtë dhe njëkohësisht janë paguar prapë nga buxheti i komunës po e kërkojmë një sqarim se cila ka qenë arsyeja që i keni shqetësuar besimtarët të cilët e frukentojnë xhaminë aty dhe njëkohësisht aj vendim ka pasur edhe një kosto shtesë.

Hajrush Shoshi – kërkesa të cilën ma jepte nuk është e protokolluar askund dhe është me 21.08.2023 masë datës së mbajtjes së mbledhjes për polic të shtrirë afër shkollës është bërë shumë herë edhe përpara kanë qenë policet e shtrirë afër shkollës.

Niman Beqiraj – e ke kërkuar Hajrush dhe ta kam për me shkrim emrat të peticionit apo kërkesë e cila i ka 22 emra, me rëndësi është të jenë zebrat kush çka ka thanë nuk është shumë me rëndësi.

Agron Gashi – kam dy pyetje: ueb faqja zyrtare e komunës së Istogut nuk është duke punuar, kam dëgjuar se nuk po funksionon edhe disa komuna tjera nga ekspertat po flitet që ka me pas dëme në mungesë të plotësimi të dokumenteve për grandin e performancës së vitit të kaluar kështu që a kish mundur dikush me ma jep një përgjigje këtu.

Si po ec procesi i pajisjes së nxënësve me libra po ka pengesa me këto aplikacione kam rastë kur prindërit me kanë thirrur për me ju ndihmua me aplikuar ndoshta edhe ju vetë keni asistuar. Kërkoj që të bëhet një zyre që me ju ndihmuar qytetarëve se vërtet po kanë probleme.

Kryetari i komunës - sqaron rreth pyetjeve të bëra.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj – sqaron rreth pyetjeve të bëra

Florin Dreshaj-unë e pata një kërkesë nga qytetarët që e kemi marrë, bëhet fjalë për ish-banuesit e ish-burgut të Gurrakocit, kryetari nuk qenka këtu nuk e di kush kishte mundur me jep përgjigje, ata janë ankuar që nuk po ju paguhet qiraja. E dini që janë zhvendos. Tash vetëm me na sqaruar a është duke u ju paguar apo jo? Ata thanë që qiradhënësi po do t'i largojë prej banese? Edhe e pata një koment për këtë debatin që u bë për librat, unë mendoj që ka qenë fat në fatkeqësi, fatkeqësi sepse nuk kanë mundur të merren vesh ministria me shtëpitë botuese për shkak të çmimeve të mëdha, por është shumë më mirë se çdo njeri i blen librat vet edhe i ruan. Vetëm një rast desha ta tregoj në Gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog për disa vite ka qenë një kamion libra të deponuara te reja, që vitin e kaluar jemi detyruar me i larguar për me e lëshuar rrugën, ato libra janë shitur nga 6 cent kg, ne fakt nuk i kemi shitur i kemi marrë dy tuba nga kamioni dy tuba letër të bardhë, është shumë gjynah sepse janë zhvat paret e qytetarëve të Kosovës. Tash shumë mirë që është bërë kështu 80 euro ju mjaftojnë. Faleminderit!

Genc Ademaj- prof po ta jap një përgjigje për çështjen e librave edhe pse nuk është e drejtë e jona sepse vendim i ministrisë është. Ma merr mendja që ma dëm i madh është me kushtuar për të njëjtin vit shkollor për vitin paraprak 1 milionë dikush po thotë 3 milionë po këto mua nuk më interesojnë. Të jesh i bindur që mbi 1 milionë ke kosto shtesë për furnizim me libra për dallim me vitin paraprak. Edhe nëse është bërë ajo që po thua ti furnizim i pa planifikuar përgjegjësia është jo te shkollat, ndoshta shumica e prindërve i kanë siguruar librat edhe po subvencionohen, edhe kjo e ka dashtë një studim pak më të thellë. Nëse shkolla fillore “Bajram Curri “ në Istog deklarohet unë i kam 10 mijë njësi që mundem klasën e parë dhe dytën ndoshta nuk kam nevojë për libra hiç dhe mos me pas nevojë ata prindër që i kanë regjistruar në klasën e parë dhe të dytën me i subvencionuar fare. Nuk mendoj që dëmtohet shteti duke botuar libra. Sa i përket pyetjes për qiranë, po të njoftoj kemi arritur një marrëveshje me një organizatë ndërkombëtare gjermane që na ka subvencionuar ka bashkë-financuar me neve në vlerë prej 6 mijë eurove për pagesën e qirasë të familjeve me gjendje të rëndë ekonomike. Çdo gjashtë muaj vazhdojnë kontratat ,një komision është në kuadër të zyrës komunale për komunitete dhe kthim që e bën rivlerësimin çdo gjashtë muaj për shkak që po ka lëvizje të madhe të qytetarëve se njëherë e kemi pas bërë së bashku me ministrinë e administrimit të pushtetit lokal që janë pas zotuar që i marrin përsipër obligimet por nuk i kanë marrë përsipër ka mbetur barrë e komunës në vazhdimësi, fatmirësisht me këtë organizatë kemi arritur këtë bashkëpunim që do vazhdoj edhe në vitet në vijim. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Arta Balaj.

Arta Balaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Duke marrë parasysh rritjen e shpenzimeve në jetën e përditshme si rezultat i ngritjes së çmimeve i të gjitha produkteve në treg, jeta e qytetarëve është vështirësuar koxha përfshirë këtu edhe zyrtarët të cilët janë të punësuar në komunën tonë, andaj propozoj drejtorisë për Buxhet dhe Financa si drejtori kompetente të inicioj për miratim në Kuvend procedurën për kod të veçantë buxhetor për shujta për stafin administrativ të komunës. Propozimin tim e mbështes edhe në komunat e tjera të cilat kanë vepruar në të njëjtën mënyrë. Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Artë! Nuk qenka as kryetari as drejtori i drejtorisë për Buxhet e Financa, ja adreson edhe njëherë. Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- edhe unë e pata pyetjen e natyrës ose me qenë kryetari ose drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Unë do të isha ndërlidhur me një pyetje më herët, marrë parasysh se vitin e kaluar qytetarët e vendit tonë kanë qenë të përfshirë nga vërshimet, në vërshimet e para komuna i ka sjellë disa ndihma që ne vetë i kemi shqyrtuar në Kuvend por herën e dytë në mungesë të buxhetit komuna nuk ka pasur mundësi me ju ndihmuar aq shumë qytetarëve dhe nga diaspora faktikisht e dimë të gjithë që i kemi pas përcjellë që janë grumbulluar një pjesë e mjeteve për qytetarët që kanë qenë të përfshirë në vërshime. Pyetja ime është kështu, a kanë arritur ato ndihma të qytetarëve deri te ju e të shpërndahen te qytetarët apo jo?

Kryesuesi i Kuvendit- kjo pyetje do adresohet te drejtori për Buxhet dhe Financa dhe brenda 30 ditëve e kanë obligim me tu përgjigj. Fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- u fol shumë rreth teksteve shkollore. Unë e kam një shqetësim këtu që qeveria e jonë nuk ka paraparë asnjë tekst shkollor për nxënësit e mësimit para fillor dhe nuk e kam parë askund asnjë diskutim rreth kësaj çështje. Është një pako që ju jepet fëmijëve të arsimit para fillor është shpërndarë në qeveritë e kaluara mirëpo në këtë rast nuk e kam parë. Është një kategori ku vet qeveria e ka paraparë e ka bërë një ligj mbi arsimin e fëmijërisë së hershme, nuk e di pse ka ndodhur ky lloj gabimi. E dyta u fol shumë edhe për atë që kanë mbetur përpara libra shumë, sigurisht që kanë mbetur mirëpo nxënësit me 1 shtator i kanë pasur librat, prandaj nëse humbet një tender për 500 mijë euro dhe rritet subvencionimi me libra edhe për dy milionë euro të tjerë edhe këtu mund të ketë ndonjë paqartësi.

Kryesuesi i Kuvendit – Falënderon për ju të gjithë që patet durimin të qëndroni deri në fund të mbledhjes, dhe dhatë kontributin e juaj,

E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.

Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:00

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova**



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije	
Ministry of Finance	
Arkiva - Arhiva - Archive	
Nr. Org. Org. Jedin Org. Unit	01/4/40
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	1026/2023
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	9
Hyrëse	PRISHTINE/A
Data Datum Date:	15.05.23

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfere /
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATE/A:	15.05.2023
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Kryeshefat e Agjensioneve, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar,
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2024/01

Të nderuar,

Më lejoni t'ju falënderoj për kontributin e juaj në hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026, që paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2024.

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2024/01, e cila ofron kufijtë fillestar buxhetor për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror dhe kufijtë buxhetor të nivelit komunal për vitin 2024-2026. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të Projektligjit të ndarjeve buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

Me respekt!

Hekuran Murati
Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve



Qarkorja Buxhetore 2024/01

1. Qëllimi

Ministri për Financa, Punë dhe Transfere është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren buxhetore 2024/01, ku ofrohen udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026, kalendarin kohor indikativ dhe kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026 për çdo organizatë buxhetore. Në rast nevojë, pas kësaj qarkoreje do të pasojnë qarkoret e tjera shtesë deri në finalizimin e buxhetit për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2024-2026

Planifikimi i buxhetit për vitin 2024 bazohet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe kornizën makro-fiskale për vitet 2024-2026. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrah kërkesat e organizatave buxhetore, brenda orientimit sektorial buxhetor të përcaktuar me KASH 2024-2026, sipas prioritetëve të përcaktuara përmes Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar nëpërmjet Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe strategji sektoriale, si dhe dokumentet që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian sikurse Programi për Reforma në Ekonomi 2023-2025 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Rrjedhimisht, prioritetet e Qeverisë për periudhën e ardhshme trevjeçare janë fokusuar në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjes së punësimit dhe një zhvillimi të qëndrueshëm, që mbron ambientin duke e ruajtur atë edhe për gjeneratat e ardhshme, si dhe orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale të KASH 2024-2026 kanë përcaktuar burimet e financimit që Qeveria mund të ketë në dispozicion për shpenzim në vitin 2024, dhe vlerësimet për vitet 2025-2026. Çdo tendencë për tejkalim të kufijve të shpenzimeve mbi kufijtë e kësaj qarkoreje e bën të detyrueshëm ndryshimin përkatësisht rritjen e burimeve të financimit, gjegjësisht ndryshimin e politikave tatimore për të arkëtuar të hyra shtesë.

Gjatë zhvillimit të procesit buxhetor, duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2024/01 është hartuar në pajtim me obligimet nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe të atyre në negocim, dhe reflekton përkushtimet për drejtimin e politikave fiskale të përcaktuara në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2023

Para prezantimit të kërkesave buxhetore për vitin 2024, organizatat buxhetore duhet t'i prezantojnë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve një parashikim të realizimit deri në fund vit të buxhetit të vitit 2023 në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Po ashtu, organizatat buxhetore duhet të identifikojnë dhe të njoftojnë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për nën shpenzimet eventuale në buxhetin aktual, para parashtrimit të kërkesës buxhetore për vitin 2024, dhe vlerësimeve për 2025-2026.

4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2024-2026

Procesi buxhetor për vitet 2024-2026 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo ndërlidhje është realizuar në priorizimin e sektorëve buxhetor në KASH 2024-2026. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e prezantuara në KASH, duke detajuar kështu përgatitjen e buxhetit në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të prezantohen vetëm në bazë të hapësirës së lirë fiskale dhe nëse të njëjtat janë përfshirë në KASH 2024-2026. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të sigurohet se totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori e përcjell shumën e paraparë me KASH 2024-2026 për këtë sektor.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre t'u japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike. Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale, duke përfshirë obligimet e shpronësimit lidhur me ato projekte;
- Zotimet e Qeverisë për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe programin – Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA);
- Legjislacioni i ri apo ndryshim plotësimi i atij ekzistues dhe
- Të përfshijnë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të jashtëm të projekteve individuale.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxheti në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026 dhe
- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet nga OB-të në nivel qendror dhe lokal zbatimit të çështjeve si në vijim:
 - OB-të të mos propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë prioritet buxhetimit të obligimeve për aktivitetet/projektet kapitale;

- Në përputhje me rekomandimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, OB-të të dërgojnë në MFPT informatë lidhur me paditë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrat ligjore për mundësinë e materializimit/shndërrimit të tyre në obligime;
- OB-të në nivel qendror dhe lokal të deklarojnë në MFPT numrin e pozitive të lira e të paplotësuar për të cilat OB nuk ka marrëdhënie punësimi dhe për të cilat nuk ka buxhet për plotësimin e tyre.
- OB-të janë të obliguara të plotësojnë të dhënat që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP si dhe duhet të eliminojnë keq klasifikimet të shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga OB qendrore apo lokale analisti buxhetor do të identifikojë keq klasifikimet, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largojë nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keq klasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
- Projektet e propozuara të jenë projekte në përputhje me Manualin e PIP dhe UA për **Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale** si dhe UA për **Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale**. Projektet të cilat nuk zbatojnë kërkesat kryesore të manualit dhe udhëzimeve administrative, nuk do të lejohen të bëhen pjesë e buxhetit.
- Me rastin e propozimit të projekteve të reja kapitale, OB-të të dorëzojnë në MFPT arsyeshmërinë për secilin projekt sipas manualit të PIP dhe udhëzimeve administrative, që përfshinë edhe kriterin e përputhshmërisë së projektit/aktivitetit të propozuar me strategjinë dhe KASH-in 2024-2026;
- Regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në SIMFK;
- Ministritë duhet të ndajnë mjete buxhetore brenda hapësirës fiskale vetëm për realizimin e atyre projekteve kapitale për të cilat në bazë marrëveshjeve të mirëkuptimit me komunat kanë krijuar obligime në të kaluarën. Nuk do të lejohen projekte të reja në nivel qendror të cilat sipas legjislacionit në fuqi janë kompetenca komunale;
- Buxhetimi i projekteve kapitale të bëhet në përputhje me **Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale**, ku pjesë e kostos së projektit janë edhe *shpenzimet e shpronësimit*. Organizatat buxhetore qendrore dhe lokale, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.
- Për projektet e reja kapitale të natyrës teknologjisë informative Organizatat Buxhetore para se të aplikojnë për mjete buxhetore duhet të marrin miratim paraprak nga Agjencia e Shërbimit të Informacionit- ASHI (MPB) se një projekt të tillë nuk mund të zbatohet nga ASHI-ja.

Vëmendje e shtuar do t'i jepet në vijim të këtij procesi nga MFPT zbatimit të kërkesave të lartpërmendura dhe vërejtjet do të regjistrohen nga analistët e buxhetit në sistemin PIP.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim të arritjes së prioriteteve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe zhvendosjen e buxhetit nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë dhe duhet të fokusohen në këto fusha: drejtësi dhe ligj; ekonomi dhe punësim; arsim; shëndetësi; siguri; integritet euro-atlantike; dhe mjedis.

Shpenzimet rrjedhëse: organizatat buxhetore duhet të bëjnë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t'u përmbahen kufijve të dhënë në Shtojcat e bashkangjitura.

Punësimi: Nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik përveç kur ka një vendim të qartë për domosdoshmërinë e punësimeve të reja dhe kur është siguruar buxheti.

Pagat dhe shitesat: *Ligji pagave për sektorin publik është aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe i publikuar në gazetën zyrtare me dt.05.01.2023 dhe si i tillë ka filluar aplikimin nga muaji Shkurt i vitit 2023.*

Për kalkulimin e pagave për vitin 2024 është marrë për bazë për llogaritje muaji mars 2023 dhe për punëtorët aktual është llogaritur shumëzuar me 12 muaj. Ndërsa për punëtorët e papunësuar është llogaritur paga mesatare dhe është buxhetuar vetëm 30%, brenda kufizimeve buxhetore.

Kjo kategori e shpenzimeve mund t'i nënshtrohet ndryshimit për organizata buxhetore varësisht prej zbatimit të procesit të ekuivalencës.

Mallra dhe shërbime: Organizatave buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

Shpenzimet komunale: priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2023.

Subvencionet dhe transferet: Subvencionet dhe transferet, pritet të rriten mesatarisht me rreth 3.7%. Do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale përfshirë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në bujqësi si dhe politikatat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

Shpenzimet kapitale: përbëjnë një pjesë konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe në periudhën afatmesme pritet që të përfaqësojnë rreth 23.9% të shpenzimeve totale. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritetesh që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohet të financohet nga huazimi i jashtëm përmes klauzolës së investimeve.

Për organizatat buxhetore të cilat konkurrojnë për fonde të huamarrjes (nga deficitin buxhetor prej 2% - përmes fondit 04) dhe nga klauzola e investimeve – përmes fondit 06 (aplikimi për fondet nga klauzola bëhet vetëm për projekte kapitale), është gjithashtu e nevojshme që projektet të plotësojnë kriteret e sipërpërmendura duke përfshirë analizën e shpenzimeve rrjedhëse para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit të cilat duhet të jenë në kuadër të projeksioneve të organizatës buxhetore.

5. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit të PIP-it. Është e rëndësishme që prioritetet strategjike të Qeverisë, ashtu si janë paraqitur në “Deklaratën e

Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2024-2026” në kuadër të KASH-it të jenë bazë për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe identifikimin e projekteve kapitale. Të gjitha organizatat buxhetore duhet të arsyetojnë kërkesat buxhetore për projektet e tyre në përputhje të plotë me Udhëzimet Administrative dhe kërkesat e PIP-it.

6. Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB)

Sistemi SZHMB-se është duke u përshtatur me mënyrën e kalkulimit të pagave dhe shtesave bazuar në Ligjin për pagat në sektorin publik, si dhe rifreskimin e planit kontabël do të jetë në dispozicion për futjen e të dhënave tentativisht nga data 01.06.2023. Sistemi i SZHMB dhe sistemi i PIP-it nuk do të lejojnë në asnjë rast tejkalim të kufijve të lëshuar me qarkoren buxhetore.

7. Indikatorët e performancës

Organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe komunal duhet të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse në nivel të organizatës buxhetore, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Organizatat buxhetore duhet të paraqesin 1 deri në 5 objektiva, të cilat janë të lidhura me strategjitë dhe mbulojnë programet më të rëndësishme. Gjithashtu kërkesat për fonde shtesë nga buxheti duhet të justifikohen në mënyrën se si ato kontribuojnë në arritjen e objektivave. Organizatat buxhetore duhet të rishqyrtojnë aktivitetet në kontekst të arritjes së objektivave. Treguesit e matjes së aktiviteteve duhet të prezantohen në mënyrë konkrete dhe të qartë për çdo aktivitet.

Forma e ofrimit të këtyre informatave dhe një shembull është dhënë në Aneksin 2. Në mënyrë specifike për secilën organizatë buxhetore duhet të ofrohen këto informata:

- **Objektivat e outputit** përshkruajnë rezultatet e pritshme nga ofrimi i shërbimeve, të cilat janë nën kontrollin e organizatës buxhetore;
- **Treguesit e outputit** matin aktivitetin e institucionit, si p.sh sasinë apo cilësinë e shërbimit ose produktit.
 - a) Indikatorit treguesi bazë;
 - b) Indikatorit treguesi i synuar;
- Aktivitetet përshkruajnë veprimet për arritjen e objektivave të deklaruara.

8. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjikor (BPGJ)

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjimore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për ”përfshirjen e buxhetimit gjikor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjimore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve” (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjimore në buxhetin vjetor për vitin 2023. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Komunat duhet të marrin parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2024-2026. Nëse ka paqartësi në këtë drejtim, organizatat buxhetore mund të konsultohen me analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneksin 1. Organizatat buxhetore gjithashtu duhet të publikojnë këto të dhëna.

9. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për 2024-2026

Organizatat Buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetore të dhënë në tabelën në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2024 dhe për dy vitet në vijim. Ju lutem të keni parasysh se këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga lëvizjet fiskale apo vendimet e Qeverisë të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve Buxhetore pasuese si dhe kualitetit të kërkesave buxhetore. Projektet kapitale të filluara nga vitet e kaluara, të cilat kanë krijuar obligime kontraktuale duhet të përfshihen brenda buxhetit për vitet 2024-2026.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore qendrore për 2024-2026.

Shtojca 1. Vlerësimet për vitet 2024-2026

Kodi org.	Ministritë/Institucionet	Vlerësimet për vitin 2024							Vlerësimet për vitin 2025			Vlerësimet për vitin 2026			
		Numri Aprovuar	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale	Rezerva	Total 2024	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2025	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2026
101	Kuvendi i Kosovës	523	6,616,701	1,819,189	200,000	70,000	200,000	-	8,905,890	9,075,536	200,000	9,275,536	9,422,913	200,000	9,622,913
102	Zyra e Presidentit	83	1,040,596	2,086,258	6,700	419,305	40,000	-	3,592,859	3,615,052	15,000	3,630,052	3,819,683	15,000	3,834,683
104	Zyra e Kryeministrit	536	4,094,151	9,751,477	83,225	5,505,687	-	-	19,434,540	14,946,668	-	14,946,668	15,677,714	-	15,677,714
201	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	2,575	22,333,034	14,080,000	1,205,077	908,017,376	42,366,752	-	988,002,239	1,014,611,971	33,120,000	1,047,731,971	1,057,419,746	29,000,000	1,086,419,746
203	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	994	7,667,848	6,467,455	314,783	69,467,022	6,154,000	-	90,071,108	86,300,058	5,174,000	91,474,058	90,268,585	5,174,000	95,442,585
204	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	331	2,412,963	12,745,543	158,280	5,246,000	4,120,000	-	24,682,786	20,697,652	3,220,000	23,917,652	21,564,572	3,320,000	24,884,572
205	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	622	4,668,754	31,513,157	481,490	1,643,814	199,337,900	-	237,645,115	40,453,160	183,038,265	223,491,425	41,472,605	203,038,265	244,510,870
206	Ministria e Shëndetësisë	1,425	12,763,813	28,368,598	281,848	3,613,805	24,629,000	-	69,657,064	50,105,780	22,403,000	72,508,780	51,217,756	22,403,000	73,620,756
220	Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves	7,538	86,248,625	64,547,091	3,639,016	-	19,299,500	-	173,734,232	158,706,419	19,449,500	178,155,919	163,828,126	19,449,500	183,277,626
207	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	816	6,666,534	5,120,027	483,908	11,616,550	43,440,000	-	67,327,019	26,841,190	46,440,000	73,281,190	27,300,312	46,440,000	73,740,312
208	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	2,216	25,114,069	23,250,000	1,640,459	6,870,360	43,012,054	-	99,886,942	58,015,591	43,862,054	101,877,645	59,584,080	43,862,054	103,446,134
